ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A – MITROVICE**

(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **UNITETI -23-10480-2-3-6**

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për **Ri-vleresim i riskut ne Vendin e punes**

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

NMA SHPK

Emri I OE:

Prishtine

Vendi

10 000

Kodi postar

Muhamet Hamiti - Drejtor

Emri I pronarit

info@nma-ks.com

e-mail

*datë: 25.04.2024*___

_____

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi per kontrate: 25.10.2023

Hapja e ofertave: 06.11.2023

Vendimi i AK-se (pas rivleresimit): 08.04.2024

Kerkesa per rishqyrtim: 12.04.2024

Vendim I rishqyrtimit: 17.04.2024

Kriteri: Tenderi i pergjegjshem me cmim me te lire

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					**Jo**	x	

Nuk eshte bere hapja e ofertave, por kerkesa per rishqyrtim eshte bere ne kritere

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	x				**Jo**		

Jemi njoftuar permes letres standarde

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura te LPP-se:

Neni 1 – Qellimi
Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efiksasiteti
Neni 7 – Barazia ne trajtim / jo diskriminimi
Neni 59 – Vleresimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tendereve
Neni 60 – Kriteret e dhenies se kontrates
Neni 42 – Njoftimi i tenderueseve i Rregullores 01/2022 per Prokurim Publik
Neni 72 – Sqarime shtese
Neni 108A - Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK per aktivitetin e prokurimit: "**Ri-vleresim i riskut ne Vendin e punes**", me nr.prokurimi: **UNITETI -23-10480-2-3-6,** me vendimin e fundit, te dates 08.04.2024 ka shperblyer me kontrate OE. NN BLI TERM – Skenderaj, i cili OE ka çmimin me te shtrenjte se oferta jone, dhe poashtu eshte OE i papergjegjshem.

Ne si OE jemi i pergjegjshem, duke i plotesuar te gjitha kriteret e kerkuara te DT-se dhe Njoftimit per kontrate.

AK me kete vendim ka bere shkeljen e nenit 60 te LPP-se, kriteret e dhenies, ku sipas kriterit te dhenies ne DT eshte kerkuar qe OE me cmim me te lire me dokumentacion te pergjegjshem te shperblehet me kontrate..

Por, AK duke mos marr parasysh kriteret e dosjes ka vepruar kunderligjshem, duke e rekomanduar per kontrate OE. BLI TERM – Skenderaj, i cili është me cmim me te shtrenjte, ku me kete veprim AK ka bere shkeljen e nenit 1 dhe 6 te LPP-se, qe kane per qellim kursimin e parase publike dhe ekonomicitetin dhe efikasitetin, ku AK duke mos i marr parasysh dispozitat ligjore te kursimit te buxhetit, ben shkeljen e nenit 7 te LPP-se (diskriminimi).

Autoriteti Kontraktues nuk I ka marr fare parasysh sqarimet dhe emailat e derguara nga ekspertja Liridona Berisha, e cila deklaron me vullnet te lire, se ka nenshkruar marreveshjen dhe poashtu lidhur me rastin e njejte I kemi derguar shkrese edhe OSHP-se, ku e gjeni te protokoluar shkresen, dhe perseri AK nuk e merr parasysh, por vetem na eliminon pa asnje sqarim shtese.

AK me vendimin B54 e ka obligim qe vendimit tia bashkangjes letrat standarde dhe arsyen e eliminimit te tij, mirepo AK ne kete rast ka bere shkejen e nenit 42 te Rregullores nr.01/2022 per Prokurim Publik e qe thote:

42.3 Formulari B58 duhet të përmbajë vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe letrat standarde përkatëse për Tenderuesit me arsyetimet e nevojshme.

Me kete rast AK ka bere shkeljen e dispozitave ligjore te LPP-se. Ku pa asnje arsye na eliminon neve dhe e shperblen me kontrate nje OE me te shtrenjte siç e potencuam me larte.

Lidhur me paqartesine apo amulline e krijuar pa asnje baze per eksperten Liridona Berisha, ku pretendimi I paqendrueshem dhe mashtrues ndaj AK-se, nga OE BLI TERM, ka qene se nuk ka patur marreveshje ne mes te neve si OE NMA SHPK dhe ekspertes Liridona Berisha, ku kjo dileme e krijuar pa asnje baze, mund te sqarohet shume lehte sipas nenit 72 te LPP-se, ku mund ti shkruani ekspertes qofte personalisht qofte permes nesh si kompani, ku kjo dilemë është shume e lehte per t'u vertetuar dhe para ligjit jemi te gjithe te barabarte.

Pra, AK duke mos kerkuar sqarime shtese nga ana jone sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se, por duke u marr me pretendime mashtruese te nje OE siq eshte OE BLI TERM, me keto veprime AK ka bere shkelje te dispozitave ligjore te LPP-se, sepse askush nuk eshte mbi ligjin dhe cdo kush qe pretendon pa asnje baze ligjore te njollos nje OE. ANDAJ, ne rastin ne fjale OE I rekomanduar (OE. BLI TERM – SKENDERAJ), duhet te mbaje pergjegjesi para ligjit dhe te futet ne listen e zeze per keto shpifje qe i ben ndaj neve si OE dhe i njejti (Bli Term) duhet te denohet sipas ligjit e jo te shperblehet me kontrate si OE mashtrues edhe pse ka ofertuar me cmim me te shtrenjte se oferta jone.

Pra, ju si AK mund ta sqaroni sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se lidhur me cdo paqartesi qe keni mund te kerkoni sqarime ku do tua deshmojme..

Ne kete lende po ua bashkangjesim edhe parashtresen e protokoluar nga OSHP qe e kemi derguar ne OSHP me nr.protokoli 1060/23 te dates 22.01.2024.

Poashtu, jemi detyruar te marrim edhe nje deklarate noteriale ne mes te kompanise NMA SHPK dhe znj.Liridona Berisha, e cila zotohet se bashkepunimi do te jete deri ne perfundim te projektit me kushtet e njejta te nenshkrimit te kontrates.

Pra, ne si OE jemi i pergjegjshem sipas kritereve te kerkuara te DT-se dhe NJK-se sipas nenit 59.4 te LPP-se (citim): ***Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse***

tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Andaj nese AK ka patur ndonje paqartesi ka mund te kerkoj sqarime shtese sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së, por nga kjo shihet se AK, konkretisht ZPP nuk ka pasur qellim te bej kursimin e buxhetit publik por ka vepruar ne kundershtim me nenin 7 te LPP-se, duke na diskriminuar si OE i pergjegjshem me çmim më të lirë se OE i rekomanduar për këtë aktivitet.

AK ka bere shkeljen e nenit 108A te LPP-se, duke mos i trajtuar pretendimet tona ankimore, bazuar ne prova dhe fakte, por AK e refuzon kerkesen per rishqyrtim si te pabazuar.

Kjo paqartesi eshte shume e lehte per tu sqaruar edhe nga eksperti shqyrtues, pasi qe nuk ka asnje dileme, edhe ne ankesen e pare OSHP, ka qene e njoftuar me shkresen e protokoluar ashtu sic e sqaruam si me larte.

Nga sqarimet e dhena si me larte është shume me rendesi ta sqarojme, se **OE i rekomanduar NN BLITERM - Skenderaj** ka ofertuar me çmim ***6,395.00 €,*** kurse ne si OE. **NMA SHPK,** kemi ofertuar me çmim **5,547.00 €,** apo ne kemi ofertuar me i lire se OE i rekomanduar per **848.00 €.**

Ky veprim i AK-se bie ne kundershtim me nenin 1 dhe 6 te LPP-se, sepse me kete veprim AK, konkretisht ZPP ka demtuar buxheti publik me vlere prej **848.00 €.**

Për çdo padrejtësi që bëhet ndaj nesh si OE, do të detyrohemi t'i shfrytëzojmë të gjitha rrugët ligjore deri sa të shpërblehemi me kontratë, jo vetëm në OSHP, por edhe në organet e tjera të shtetit.

Pra, bazuar ne sqarimet e dhena te paraqitura si me larte, kerkojme nga OSHP që të merr :

V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e OE. NMA SHPK - Prishtine,te anulohet VENDIMI I AK-se dhe lenda te kthehet ne

RIVLERESIM, i aktivitetit pasi qe jemi OE i pergjegjshem sipas kritereve te DT-se dhe NJK-se.

SHPERBLEHEMI me dhenie te kontrates, pasi qe jemi OE i pergjegjshem, por ne rast se AK ka nevoje per sqarime shtese mund te kerkon sipas nenit 72 te LPP-se.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Demet materiale deri me tani kapin shumen afro 3,800 €, ku hyjne shpenzimet e sigurimit te ofertes, marreveshjet e tjera, sherbimeve juridike etj

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*